

Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i kontratave të nënshkruara për kryerjen e punimeve nga *SHPK*, në Bashkinë Shkodër, u konstatua dëm ekonomik në shumën **6,788,605 lekë**, për punime të pakryera dhe vonesa në zbatimin e kontratave, si më poshtë:

Në zbatimin e punimeve civile në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Zooteknike - Shtëpia e Bujqëve” i vitit 2011, me vlerë totale 79,999,590 lekë, u konstatuan vonesa gjatë ekzekutimit të kontratës me 33 ditë. Referuar penealiteteve të përcaktuara në nenin 34 të kontratës së lidhur midis palëve, rezulton se vlera e penalitetit për vonesat e shkaktuara nga operatori ekonomik *SHPK*, është **263,998 lekë, e cila përbën dëm ekonomik**.

Në zbatimin e punimeve civile në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Zooteknike - Shtëpia e Bujqëve” i vitit 2011, me vlerë totale 79,999,590 lekë, u konstatuan diferenca në zëra punimesh duke përfituar padrejtësisht operatori ekonomik *SHPK* dhe shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 6,524,606 lekë**.

Për sa më sipër rekomandojmë:

*Ministria e Brendshme, Njësia e zbatimit të Projektit, Bashkia Shkodër të marrin masa që ti kërkojnë operatorit ekonomik SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e shumës **6,788,605 lekë**, të përfituar padrejtësisht në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Zooteknike - Shtëpia e Bujqëve”. Referuar marrëveshjes së financimit, 30% e kësaj vlere është për buxhetin e Bashkisë Shkodër, 20% për buxhetin e pushtetit qendror dhe 50% për Ministrinë e Brendshme.*

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT